

BOTIMET



BRERORE



Ernst Jünger

**MOBILIZIMI
TOTAL**

ERNST JUNGER

MOBILIZIMI TOTAL

Perktheu: Juxhin Halo
Redaktoi: Orsin Bakalli
© Botimet Brerore
brerore@outlook.com
2024

Mobilizimi Total – Ernst Junger

1) Të kërkosh fytyrën e vërtetë të luftës në një vend që varet nga veprimi njerëzor shkon në kundërshti me natyrën e shpirtit heroik. Prapëseprapë, shndërrimet dhe maskimet e shumta që pëson trajta e pastër e luftës gjatë peripecive të kohës dhe hapësirës njerëzore i sjellin këtij shpirti një shpalosje që të mbërthen.

Kjo shpalosje na sjell në mendje vullkanet të cilët edhe pse gjenden në rajone shumë të larmishme vjellin po të njëjtin dhe të zjarrtë. Të marrësh pjesë në një luftë është diçka e ngjashme me të qenurit pranë një mali të atillë zjarrvjellës. Por ka një dallim të madh mes Heklës në Islandë dhe Vezuvit në Gjirin e Napolit. Edhe mund të thuhet se dallimi i peizazhit nis e zhduket ndërsa je duke ju afruar nofullave të ndritshme të kraterit.

Gjithashtu në çastin që pasioni I njëmendtë shpërthen e mbi të gjitha në përpjekjen e drejtpërdrejtë e të hapur për jetë a vdekje. Merr një rëndësi dytësore se në cilin shekull, për shkak të çfarë ideve dhe me anë të të cilave armë po luftohet beteja.

Por eseja jonë ka një tjetër temë.

Në vend të kësaj ne do të përpiqemi të rreshtojmë një sërë faktesh që e dallojnë luftën e fundit, luftën tonë, ngjarjen më të madhe e më me ndikim të epokës tonë nga luftrat e tjera historia e së cilave na është lënë si trashëgimi.

2) Ndoshta mund ta njohim natyrën e veçantë të kësaj katastrofë madhore me anë të pohimit se gjatë saj gjenialiteti I luftës u përfshi nga fryma e përparimit. Nuk ishte kështu vetëm për luftimet mes vendeve të ndryshme por v lente edhe për luftën civile që solli të korra të bollshme për herë të dytë në disa prej tyre. Këto dy dukuri, luftë botërore dhe revolucion botëror janë të ndërthurura më tepër se sa shfaqet në pamje të parë. Janë dy anë të një ngjarjeje me rëndësi kozmike, shpërthimi dhe origjina e të cilave janë të ndërvarura në mënyra të ndryshme.

Ka gjasa se shumë zbulime të pazakonta na presin në mendje për sa I përket realitetit që fshihet pas idesë së “përparimit”, një ide e turbullt e me plot xixëllime shumëngjyrëshe. Pa dyshim që mënyra se si priremi këto kohë të tallemi me të vjen lehtë. Sigurisht mund të përmendnim se çdo mendimtar me rëndësi nga shekulli I XIX-të mbështet mospëlqimin tonë. Sidoqoftë nga gjithë neveria jonë për plogështinë dhe njëtrajtshmërinë e qënieve në shqyrtim lind dyshimi se *burimi* I tyre është I një rëndësie shumë më të madhe. Përfundimisht edhe procesi I tretjes varet nga fuqitë e një Jete të mrekullueshme dhe të pashpjegueshme.

Padyshim se sot mund të vërtetohet bindshëm se përparimi nuk është, në fakt, vërtet *përparim*. Por më me rëndësi se kjo bindje, ndoshta, është pyetja nëse rëndësia e vërtetë e idesë nuk është e një lloji më të mistershëm dhe të ndryshëm: një I cili përdor me sa duket maskën jo të fshehur të arsyes si një vend I shkëlqyer fshehjeje. është pikërisht qëndrueshmëria me të cilën lëvizjet përparimtare sjellin pasoja në kundërshtim me prirjet e tyre më të brendshme që na lë të kuptojmë se këtu, si kudo në jetë, ajo që triumfon nuk janë dhe aq këto prirje por instikte të tjera më të fshehta.

“Fryma”, me të drejtë, shpesh është argëtuar me tallje me kukullat prej druri të përparimit. Por fijet e holla që I lëvizin këto kukulla janë të padukshme.

Nëse dëshirojmë të mësojmë diçka mbi strukturën e kukullave, nuk ka udhërrëfyes më të këndshëm se romani I Floberit *Buvar dhe pekushe*. Por nëse dëshirojmë të shqyrtojmë mundësitë e kësaj lëvizjeje më të fshehtë, një lëvizje më e lehtë për ta ndjerë se për ta vërtetuar- si Paskali edhe Hamani na sjellin një bollëk paragrafesh demaskues.

“Ndërkohë, fantazitë, vegimet, iluzionet pamore dhe rrenat qëndrojnë nën sundimin e Zotit.” Ne ndeshim deklarata të këtij lloji shpesh herë tek Hamani; ato pasqyrojnë një ndjeshmëri që përpiqet të përftojë punët e kimisë në rrafshin e alkemisë. Le ta lemë mënjane pyetjen se cili shpirt mbretëron mbi iluzionin pamor të përparimit: ky studim nuk është demonologji por synohet për një lexues të shekullit të njëzetë. Sidoqoftë, një gjë është e sigurt: veç një fuqi me origjinë kultike, vetëm një *besim* do mund të krijonte diçka kaq kokëkrisur sa të zgjerimin e botëvështrimit të dobisë në pafundësi.

Dhe kush, atëhere, do të vendoste në dyshim faktin se përparimi është kisha e madhe popullore e shekullit të nëntëmbëdhjetë, e vetmja që gëzon autoritet të vërtetë dhe besim pa mëdyshje?

3) Me një luftë që plasi në një atmosferë të tillë, marrëdhënia e çdo individi pjesëmarrës me progresin që e detyruar të kishte një ndikim vendimtar. Dhe pikërisht këtu qëndron faktori moral origjinal (i paprecedent) i epokës sonë: edhe ushtritë më të fuqishme të pajisura me armët më të reja të shfarosjes të epokës industriale nuk maten dot me pasojat e panjohshme e të stërholluara (imta) të kësaj periudhe pasi kjo epokë mund të pajtojë ushtarë madje edhe nga fushimi i armikut.

Në mënyrë që të qartësohet kjo gjendje, le të paraqesim këtu idenë e mobilizimit të plotë(tërësishëm). Kanë mbaruar me kohë ditët kur mjaftonte të nisje për betejë njëqind mijë trupa të pajtuara rekrutuara e të drejtuara nga prijës të besueshëm, njëjtë siç hasim te Kandidi i Volterit për shembull. E kur, nëse Madhëria e Tij humbiste një betejë, detyra e parë e qytetarit ishte të heshte. Megjithatë, edhe në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, qeveritë konservatore mund ende të përgatisnin, zhvillonin e fitonin luftra të cilat përfaqësuesit e popullit i shpërfillnin ose edhe kundërshtonin.

Sigurisht kjo merrte për të mirëqenë një marrëdhënie të ngushtë midis kurorës dhe ushtrisë; një marrëdhënie që kishte pësuar vetëm një ndryshim sipërfaqësor nëpërmjet sistemit të ri të rekrutimit të përgjithshëm, një marrëdhënie që në thelb ende i përkiste botës patriarkale.

Mbështetej gjithashtu mbi një llogaritje të ngulitur(pandryshueshme) të armatimeve dhe shpenzimeve që e bënin luftën të ngjante si një shpenzim i jashtëzakonshëm por kurrsesi jo i pafundëm i forcave dhe rezervave të disponueshme. Në këtë anë, edhe mobilizimi i përgjithshëm kishte veçoritë e një veprimi(mase) të pjesshëm(pjesshme).

Këto kufizime nuk pasqyrojnë vetëm shkallën e kufizuar të mjeteve por gjithashtu një justifikim/arsye shtetërore të veçantë. Instikti natyror që ka monarku e paralajmëron atë që të mos tejkalojë kufijtë e pushtetit dinastik. Shkrirja e thesarit të tij ngjan më pak e kundërshtueshme se borxhet e pranuar nga një kuvend dhe për çastin vendimtar të betejës ai do të parapëlqente (më tepër) të mbante në rezervë truporjen e tij se sa një grup vullnetarësh.

E hasim këtë instikt të ruajtur në gjendje të shëndetshme në Prusi deri vonë në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Një shembull midis të shumtëve është përpjekja e ashpër për një rekrutim tre vjeçar; duke pasur parasysh që një periudhë e shkurtër shërbimi është tipar shquës për një ushtri vullnetare, kur pushteti dinastik është në rrezik, ushtarët e sprovuar e të regjur janë më të besueshëm. Shpesh madje ne hasim çka do të ishte pothuajse e paimagjinueshme me pritshmëritë e të sotmes, në një braktisje të përparimit dhe çdo pajimi të përkryer të ushtrisë por ngurime të tilla kanë gjithashtu arsytet e veta.

Prandaj pas çdo përmirësimi të armëve të zjarrit - veçanërisht (në veçanti) rritja e largësisë së qitjes - fshihet një sulm i tërthortë ndaj kushteve për mbretër të pakufizuar. Secili përmirësim i tillë nxit goditjen e shënjestrave (objektivave) të veçanta ndërsa goditja me batore mishëron fuqinë e drejtimit (komandimit) të ngurtë (palëvizshëm, hierarkik). Entuziazmi ishte ende i pakëndshëm (papëlqyeshëm) për Vilhelmin e Parë.

Entuziazmi buron nga një vend, si thesi me erëra i Eolit, ku fshihen jo vetëm stuhi duartrokitjesh. Kriteri i vërtetë me anë të të cilit gjykohet autoriteti nuk është masa e gëzimit (festimit, hareshë) që sjell por luftërat që janë humbur. Mobilizimi i pjesshëm si rrjedhim i përshtatet thelbit (natyrës) të monarkisë. Kjo e fundit i kalon caqet e veta deri në pikën ku detyrohet të bëjë trajtat (gjërat) abstrakte të shpirtit, parasë, "popullit"-shkurtimisht, forcat e demokracisë kombëtare në rritje - pjesë të përgatitjes për luftë.

Në prapavështrim ne mund të themi tani se braktisja e plotë e një pjesëmarrjeje të tillë ishte deri diku e pamundur. Mënyra në të cilën u përfshi [në jetën politike] përfaqëson thelbin e vërtetë të shtetbërjes. Këto rrethana të veçanta i japin shpjegim thënies së Bismarkut që politika është "arti i të mundshmes".

Tani ne mund të ndjekim procesin me anë të së cilit shndërrimi në rritje I jetës në energji, qënies gjithmonë e më tepër kalimtare të lidhjeve në të mirë të lëvizshmërisë, I jep një natyrë gjithmonë e më të skajshme veprës së mobilizimit – që në shumë shtete ishte e drejtë e veçantë e kurorës, pa patur nevojë për firmosje nga të tjerë.

Ngjarjet që e shkaktuan këtë janë të shumta: me shkrirjen e pasurive dhe kufizimin e privilegjeve të fisnikërisë, koncepti I një kaste luftëtarësh zhduket gjithashtu; mbrojtja e armatosur e shtetit nuk është më detyra e veçantë dhe e posaçme e ushtarit profesionist por është përgjegjësia e kujtdo që mund të përdorë armë.

Gjithashtu, për shkak të rritjes gjigande të shpenzimeve, është pothuajse e pamundur të mbulosh kostot e luftës duke u mbështetur mbi një buxhet të ngulitur luftime; më mirë, një tërheqje e të gjitha kredive të mundshme, madje një taksim deri të qindarkës së fundit të kursyer, nevojitet për ta mbajtur në lëvizje makinerinë. Në mënyrë të njëjtë, trajta e luftës si përlëshje e armatosur shkrihet me trajtën më të gjerë të proceseve vigane të punës.

Përveç ushtrive që përplasen në fushëbeteja, shfaqen ushtritë moderne të tregtisë dhe transportit, ushqimeve, prodhimit të armatimeve, ushtria e punëtorisë në përgjithësi. Në etapën e fundit, e cila tashmë kishte dhënë shenja që aty nga fundi i luftës së fundme, nuk ka as edhe një veprimtari- qoftë edhe ajo e amvisës duke punuar me makinën e saj të qepjes- që nuk përdoret qoftë edhe vetëm tërthorazi për fushën e betejës. Në këtë rreshtim të pafundëm të energjive të mundshme, që I shndërron vendet e industrializuara ndërluftuese në farka

vullkanike, ne ndoshta ndeshim tiparin më befasues të agimit të epokës së punëtorisë.

E kthen Luftën Botërore një ngjarje historike me rëndësi më të madhe se Revolucioni Francez. Që të përdoren energji të këtyre përmasave, mbathja e një krahu me armë nuk është më e mjaftueshme; pasi ky është një mobilizim që lyp mundim deri në palcë, organin më të stërholluar të jetës. Detyra e mobilizimit total është arritja e kësaj gjëje: një vepër që, si me një prekje të panelit të kontrollit, përçon fuqinë thellësisht të degëzuar e me vena të dendura të jetës moderne drejt rrymës së madhe të energjisë luftarake.

Në fillim të Luftës Botërore, mendja e njeriut ende nuk e kishte parashikuar një mobilizim të përmasave të tilla. Sidoqoftë, shenjat e veta u shfaqën në raste të rralla- për shembull, pajtimi i madh i vullnetarëve dhe rezervistëve në fillim të luftës, ndalimi i eksporteve, rregullat e censurës, ndryshimet në kursin e monedhës.

Gjatë luftës kjo veprimtari u shtua: si shembuj, mund të përmendim përdorimin e planifikuar të lëndës së parë dhe ushqimeve, përshtatjen e kushteve industrial për rrethanat ushtarake, shërbimin rojë të joushtarakëve, armatosjen e anijeve tregtare, fuqizimin e papritur të autoritetit të shtabit të përgjithshëm, “programin Hindenburg”, përpjekjen e Ludendorfit për njësimin e udhëheqjes ushtarake dhe politike.

Sidoqoftë, pavarësisht shfaqjes aty nga fundi, si madhështore edhe tmerruese, të “betejave të makinerive”, në të cilat dhuntia njerëzore për organizim arrin fitoren e saj të përgjakshme, mundësitë e një mobilizimi total ende nuk janë shfrytëzuar.

Edhe nëse e kufizojmë fushëveprimin/shtrirjen tonë vetëm tek ana teknike e veprimtarisë, ky mund të ndodhë vetëm kur gjendja e veprimeve luftarake urdhërohet edhe gjatë kushteve(kohës) së paqes. Rrjedhimisht ne shohim se në kohën e pasluftës, shumë vende përgatisin mënyra të reja të armatimit sipas modelit të mobilizimit total.

Në këtë drejtim, ne mund të paraqesim shembuj si kufizimi në rritje i “lirisë vetjake”, një privilegj që, të jemi të qartë, ka qenë gjithnjë i dyshimtë. Një sulm I tillë ndodh në Rusi dhe Itali e më vonë edhe këtu në Gjermani; qëllimi i tij është të mohojë qenien e çdo gjëje që *nuk* I shërben shtetit. Ne mund të parashikojmë një kohë kur të gjitha vendet me synime botërore do ti duhet të nisin procesin, në mënyrë që të mbështesin lëshimin/çlirimin/derdhjen e trajtave/llojeve të reja të fuqisë. Gjykimi/vlerësimi francez i barazpeshës së pushtetit sipas këndvështrimit të *energjisë së mundshme* i takon/shkon këtyre rrethanave, ashtu si modeli që ka sjellë Amerika- tanimë në kohë paqeje- për bashkërendim midis industrisë dhe ushtrisë. Letërsia gjermane e luftës ngriti çështje që preknin mbi vetë thelbin e armatimit, duke e detyruar publikun e gjerë të bëjë gjykime mbi çështjet e luftës(edhe pse disi me vonesë dhe në të vërtetë duke parashikuar të ardhmen).

Për herë të parë, “plani pesë vjeçar” rus i shfaq botës një përpjekje për të tejçuar energjitë e përbashkëta të një perandorie të madhe kah një drejtimi të vetëm. Duke parë këtu sesi teoria ekonomike kthehet kokëposhtë është mësimdhënëse. “Ekonomia e planifikuar”, si një nga rezultatet finale të demokracisë, e tejkalon veten duke u kthyer në një shpalesje të gjithëanshme fuqie. Mund të vërehet ky ndryshim në shumë ngjarje të kohës sonë. Dyndja/vala e madhe e masave në këtë mënyrë/kështu arrin një pikë kristalizimi.

Deri tani, jo vetëm sulmi por edhe mbrojtja lypin mund të jashtëzakonshëm dhe këtu ndoshta shtrëngimet e botës bëhen edhe më të qarta.

Njëloj siç çdo jetë i mbart farat e vdekjes së saj, kështu edhe shfaqja e masave të mëdha të popullsisë e mbart brenda vetes një demokraci/demokratizim/masivizim të vdekjes.

Koha e qitjes së saktë tashmë ka përfunduar. Kur jep urdhrin për bombardim gjatë natës, drejtuesi i togës nuk bën dallim midis luftëtarëve dhe joluftëtarëve, reja e gazit vdekjeprurës rri pezull mbi çdo gjë të gjallë si një forcë e natyrës.

Por, sa I mundshëm është një rrezik i tillë nuk varet as nga një mobilizim i kufizuar e as nga një i përgjithshëm por, përkundrazi, një mobilizim total. Shkon deri tek fëmija në djep që rrezikohet njësoj si gjithë të tjerët biles më tepër.

Mund të përmendim shumë shembuj të tillë. Mjafton thjesht të shqyrtojmë jetën tonë të përgjithshme, me rrjedhën e saj të pashmangshme dhe disiplinën e saj të pamëshirshme, tymnajën dhe ndriçimin e saj, pjesën lëndore dhe përtejlëndore të tregtisë së saj, motorët, aeroplanët dhe qytetet në lulëzim.

Me një tmerr të përzier me kënaqësi, ne ndiejmë se këtu, as edhe një grimcë nuk rri palëvizur, ne ndiejmë se jemi të përfshirë thellësisht në këtë veprimtari të stuhishme.

Mobilizimi Total përmbushet shumë më pak se sa përmbush vetveten??; në luftë dhe paqe, zbulon nënshtrimin e fshehtë e të paepur nën të cilin na vendos jeta jonë në epokën e masave/turmave dhe makinerive.

Rrjedhimisht arrijmë në përfundimin se çdo jetë e veçantë kthehet, edhe më qartë, në jetën e një punëtori dhe se, pas

luftrave të kalorësve, mbretërve dhe qytetarëve, ne tani kemi luftrat e *punëtorëve*. Përleshja e parë e madhe e shekullit të njëzetë na ka paraqitur si me trajtën/përbërjen e arsyeshme (strukturën racionale) edhe me pamëshirshmërinë e tyre.

4) Kemi folur për anët teknike të Mobilizimit Total; përkryerja e këtyre mënyrave mund të prapagjurmohet duke nisur nga rekrutimet e para të qeverisë së Kuvendit gjatë Revolucionit Francez dhe riorganizimi i ushtrisë nga Sharnhorsti¹ e tek programi i zhdërvjellët i armatimit gjatë viteve të fundit të Luftës së Madhe – kur shtetet e shndërruan veten në punishte vigane, duke prodhuar ushtri në linjën/vijën e montimit të cilat i nisnin drejt betejës ditë e natë, aty ku një gjojë/grykë e përgjakur njëlloj mekanike merrte përsipër rolin e gllabërueses.

Njëtrajshmëria përsëritëse e një shfaqjeje të tillë- që të sjell në mendje pamjen e një turbine që punon me saktësi e përdor si lëndë djegëse gjakun- shkakton vërtet dhimbje tek ata me dell heroik; prapëseprapë, nuk mund të ketë dyshim mbi kuptimin e vet simbolik. Këtu na shfaqet rreptë/egër një pashmangshmëri: vula e fortë e një epoke që përçohet/ndërmjetësohet nga lufta. (:një epokë që do e shquajë lufta).

1 Shënim i përkthyesit: Gerhard Johan David Sharnhorst(1755-1813), gjeneral Prusian dhe krijues i sistemit ushtarak Prusian modern. Pas humbjeve të Prusisë gjatë luftrave Napoleoniane ai e përmirësoi ushtrinë Prusiane duke ndalur pajtimin e ushtarëve kryesisht me pagesë (duke ndryshuar natyrën kryesisht mercenare të saj) dhe në vend të kësaj zgjodhi krijimin e një force kombëtare të mbështetur në thirrje të gjithëanshme nën armë.

Sidoqoftë, ana teknike e Mobilizimit Total nuk është vendimtare. Themeli i anës teknike- si ai i gjithë teknologjisë- shkon më thellë. Do ta trajtojmë këtu si *gatishmëria* për mobilizim. Një gatishmëri e tillë gjendej kudo: Lufta Botërore ishte një nga luftërat më popullore që njeh historia për shkak se u zhvillua në një epokë që përjashtonte parimisht të gjitha luftrat ,përveç atyre popullore(jopopullore). Gjithashtu, përveç luftrave dytësore/të kufizuara kolonialiste dhe plaçkitëse, kombet e përfshira në Luftën Botërore kishin shijuar një periudhë pak a shumë të gjatë paqeje.

Megjithatë, në fillim të hetimit tonë premtuam prerazi se nuk do të përqëndroheshim tek shtresa parake e natyrës njerëzore, tek ajo përzierje ndjenjash të egra e fisnike(të fisme) që prehen brenda saj e që e bëjnë gjithnjë të prekshme/ndikueshme nga britmat e luftës. Më mirë të përpiqemi të shquajme/dallojmë shenjat e shumta që paralajmëruan dhe shoqëruan këtë përleshje të veçantë.

Kurdoherë që përballemi me përpjekje të këtyre përmasave, që kanë tiparin e veçantë të “kotësisë” – si lartësimi i ngrehinave vigane si piramidat dhe katedralet, ose luftrat që nxisin/lypin përdorimin/shterimin e gjithë fuqisë jetike – shpjegimet ekonomike, pavarësisht sa ndriçuse janë, nuk mjaftojnë. Për këtë arsye shkolla e materializmit historik vetëm mund të zbulojë sipërfaqen e procesit.

Që të shpjegohen sprovime/përpjekje të këtij lloji, do ishte më mirë të përqëndronim dyshimet tona fillestare mbi dukuri me një natyrë fetare.

Kur e quajtëm/përcaktuam përparimtarizmin si kishën popullore të shekullit të nëntëmbëdhjetë, tashmë e veçuam/sugjeruam se cili ishte burimi i tërheqjes së vërtetë që

ndiente masa e gjerë, pjesëmarrja e së cilës ishte kaq e nevojshme, ndaj luftës së fundit. Vetëm kjo tërheqje mund të shpjegojë natyrën vendimtare që kishte Mobilizimi i tyre Total, natyrën fetare të fuqisë së besimit.

Bishtënimi i luftës (shmangia, bërja bisht e luftës) ishte edhe më i pamundur në raport me (duke e krahasuar me, duke parë) shkallën e bindjes së tyre- pra në përpjestim me pastërtinë e përbërjes përparimtariste që kishin fjalët kumbuese që i nxisnin drejt veprimit (të vepronin).

Pa dyshim, këto fjalë shpesh kishin ngjyrim të ashpra e të frikshme; efektshmëria e tyre nuk ka dyshime. I përngjanin leckave me ngjyrë të theksuar që e çojnë prenë e ndjellë në drejtim me tejtkyresen e pushkës.

Madje edhe një vështrim i përciptë, që i ndan gjeografikisht palët ndërluftuese në fitues e të humbur, duhet të pranojë përparësinë e kombeve “përparimtariste”. Kjo përparësi duket se ndjell (sjell në mendje) një veprimtari me natyrë parapërcaktuese shkak-pasojë si për shembull teoria Darwiniste e mbijetesës së më të “aftit (përshtatshmit)”.

Cilësia parapërcaktuese e përparësisë është në veçanti e dukshme në paaftësinë e vendeve fitimtare si Rusia dhe Italia për të shmangur një shkatërrim të plotë të sistemeve të tyre politike. Nga ky këndvështrim, lufta duket si një mënyrë e sigurt sprovimi, që i mbështet gjykimet e veta të vlerave mbi ligjësi të rrepta dhe të thella, si një tërmet që vendos në provë themelet e çdo ndërtese.

Nga ana tjetër, fuqia e papritur e sistemit përparimtarist për të bërë qëndresë, qoftë edhe në një gjendje dobësimi të madh fizik

të shkakton habi. Për këtë arsye (si rrjedhim), gjatë shtypjes nga ana e ushtrisë franceze të asaj kryengritjeje shumë të rrezikshme të vitit 1917, një “mrekulli e dytë morale e Marnës” shpaloset, më zbuluese për simptomat në këtë luftë se thjesht faktorët ushtarakë.

Në mënyrë të ngjashme, në Shtetet e Bashkuara me kushtetutën e tyre demokratike, mobilizimi mund të kryhej me një rreptësi që ishte e pamundur në Prusi, ku e drejta e votës varej nga klasa.

E kush mund të vendosë në dyshim faktin se Amerika, vendi ku nuk ka “kështjella të rrënuara, kollona bazalti dhe përralla/rrëfenja me kalorës, fantazma e banditë”, doli qartësisht fitimtarja e kësaj lufte? Fati i saj u vendos tashmë jo nga shkalla në të cilën shteti ishte një “shtet ushtarak” por nga shkalla në të cilën ishte i aftë të kryente Mobilizim Total.

Megjithatë ishte fati i paracaktuar i Gjermanisë që ta humbiste luftën edhe nëse do të kishte fituar betejën e Marnës dhe luftën e nëndetëseve pasi, pavarësisht gjithë kujdesit me të cilin ndërmoi një mobilizim të pjesshëm, ende kishte mundësi të mëdha për të kryer Mobilizim Total.

Për të njëjtën arsye, në përputhje me natyrën e brendshme (llojin, karakteristikën) e armatimit të vet, ishte me siguri e aftë për të arritur, ruajtur e mbi të gjitha shfrytëzuar fitore të pjesëshme por kurrë triumf të plotë. Për ta arritur një sukses të *tillë* me armët tona do të kishte qenë e nevojshme të kishim qenë të përgatitur për një tjetër Kanae, një jo më pak me rëndësi se ajo të cilës i kushtoi mundin e jetës Shlifeni². Por

2 Shënim i përkthyesit: Në betejë e Kanaes në 216 P.K. Hanibali mposhti Romakët. Në historinë e luftimit, beteja shquhet si shembulli më i përkryer i sulmit dhe rrethimit të dyfishtë (nga dy krahe/drejtime) i një ushtrie kundërshtare. Ju desh Romës pothuajse një dhjetëvjeçar për të

para se të shtjellojmë më tej këtë argument, le të shqyrtojmë disa pika të ndryshme me shpresën se tregojmë më qartë lidhjen midis përparimit dhe Mobilizimit Total.

5) Një fakt është qartësisht ndriçues/sqarues për ata që duan të kuptojnë fjalën përparim deri në thelbin e vet të pafinesë(mbase edhe guximshëm/shkëlqyer?): në një epokë që ekzekutoi publikisht, nën torturë të tmerrshme, një Ravailak ose edhe një Damien³ të akuzuar si pjellë nga skëterra, vrasja e anëtarëve të familjes mbretërore do të dëmtonte një shtresë shoqërore më të fuqishme –një të prirur më tepër të besojë/zhytur më thellë në besim- në krahasim me shekullin që pasoi ekzekutimin e Luigjit të XVI-të.

Zbulojmë se/Doli që në hierarkinë e përparimit, princi nuk i përket një lloji që ka privilegje të veçanta.

Le të imagjinojmë, për një çast, rrethanat e shëmtuara/shpërfytyruara në të cilat një drejtori të një sipërmarrjeje të madhe reklamash i duhet të përgatisë propagandën për një luftë moderne.

Duke patur dy mundësi të gatshme për të shkaktuar shkëndijën e parë të zemërimit- më saktë, atentatin e Sarajevës ose

rimarrë veten nga humbja.

Gjenerali Alfred von Shlifen(1833-1913) ishte kreu i shtabit të përgjithshëm Gjerman nga viti 1891 deri në vitin 1906. Ai ishte përgjegjës për “planin Shlifen” të zbatuar në Luftën e Parë Botërore që trajtonte problemin e luftimit në dy fronte.

3 Shënim i përkthyesit: Fransua Ravailak (1578-1610), mbretvrasës që kreu atentat ndaj mbretit Henri të IV-ët.

Robert-Fransua Damien (1714-1757), i cili u torturua dhe ekzekutua për përpyekjen e tij për të marrë jetën Luigjit të XV-të.

dhunimin/shkeljen e paanësisë Belge- nuk ka dyshim se cila do të shkaktonte efektin më të madh.

Shkaku sipërfaqësor i Luftës Botërore- pavarësisht sa i rastësishëm/rastësor duket- mbart/ka një kuptim simbolik: në rastin e fajtorëve të Sarajevës dhe viktimës së tyre, trashëgimtarit të kurorës Habsburge, parimet kombëtare dhe dinastike u përplasën- modernia “e drejtë për vetëvendosje kombëtare” me parimin e ligjshmërisë të ripërtërirë me mund në Kongresin e Vienës(1815) me anë të shtetformimit të dorës së vjetër.

Tani pavarësisht se ishte e parakohshme (ndodhi në kohën e gabuar) në kuptimin e mirëfilltë të fjalës meriton lavdërim pasi shkaktoi një efekt të fuqishëm tek një shpirt që dëshiron të ruajë një trashëgimi.

Por kjo gjë kërkon/ka nevojë për besim. Sidoqoftë është e qartë se ideologjia e Fuqive të Boshtit Qëndror nuk ishte as e kohës, as e parakohshme as përtej kohës. Përkundrazi, gjendja shpirtërore ishte njëkohësisht e kohës së duhur dhe e prapambetur që krijonte në asgjë tjetër veçse një përzierje të romantizmit të rremë dhe liberalizmit të papërshtatshëm.

Si rrjedhim vëzhguesi nuk mund të mos vërente një prirje për të përdorur vjetërsira, një stil të vonë romantik, për operat e Wagnerit në veçanti. Fjalë që kujtonin besnikërinë e Nibelungëve, shpresa të varura tek suksesi i thirrjes së Islamit për luftë të shenjtë janë disa shembuj.

Sigurisht që u kryen diskutime mbi teknikën dhe mbi qeverisjen, mobilizimi i lëndës por jo lënda vetë. Por marrëdhënia e papërshtatshme e klasës qeverisëse si me masat

edhe me fuqitë më të thella e tregoi/shfaqti veten saktësisht tek gafat e këtij lloji.

Rrjedhimisht edhe përmendja e famshme dhe paqëllimisht e shkëlqyer e një “copë letre” ka fatin e keq të jetë kryer 150 vite me vonesë dhe veç kësaj sipas parimeve që mund ti leverdisnin Romantizmit Prusian por që në thelb nuk ishin Prusiane.

Pra, Frederiku i Madh mund të kishte folur, duke u tallur me pergamenën e zverdhur e të mykur, si një despot/satrap i përndritur. Por Bethman-Holvegu duhet ta ketë ditur se në ditët tona një copë letër, bie fjala një letër në të cilën është shkruar një kushtetutë, ka një kuptim/vlerë të ngjashëm me atë që ka buka e shenjtëruar për Kishën Katolike.

Të grisësh traktate patjetër që i përshtatet absolutizmit(sundimit të plotfuqishëm) por fuqia e liberalizmit qëndron tek shpjegimi i tyre.

Hulumto shkëmbimin e njoftimeve/lajmërimeve që i parapriu futjes së Amerikës në luftë dhe do të gjesh një parim të “lirisë së deteve”, një shembull i mirë se çfarë rang u jepet në një epokë të tillë interesave vetjake të dikujt, kthehen në aksioma humanitare/njerëzoriste. çështja ngatërron gjithë njerëzit e botës. (çështja ka ndikim të përbotshëm).

Demokracia shoqërore Gjermane, një nga shqytet e përparimtarizmit Gjerman, kuptoi anën dialektike të qëllimit të saj(gjeti thelbin dialektik të detyrës së saj) kur e barazoi/njësoi kuptimin e luftës me shkatërrimin e regjimit kundërpërparimtarist të carit.

Por çfarë kuptimi ka kjo në krahasim me mundësitë e mobilizimit të masave që Perëndimi kishte në gatishmëri? Kush do të mohonte se “*qytetërimi*” është i lidhur më thellë me

përparimtarizmin se sa “*Kultura*”, se gjuha e “*qytetërimi*” flitet në qytetet e mëdha dhe se “*qytetërimi*” ka mjete dhe ide nën urdhrat e tij drejt të cilave *Kultura* është ose armiqësore ose shpërfillëse? *Kulturën* nuk e përdor dot për propagandë.

Një qasje që përpiket ta shfrytëzojë atë në këtë mënyrë e largon(huajson?) *Kulturën* njësoj siç ne shohim kotësinë apo edhe trishtimin tek shpërblimi i shpirtave të mëdhenj Gjermanë me vendosje të fytyrave të tyre në miliona pulla poste apo kartëmonedha.

Sidoqoftë, ne nuk kemi dëshirë të ankojemi për të pashmangshmen. Duam vetëm të vërtetojmë se Gjermania ishte e paaftë të përvetësonte/përqafonte fort shpirtin e kohës pavarësisht natyrës së tij. Gjermania ishte gjithashtu e paaftë ti paraqiste vetes apo botës një parim të vlefshëm sipëror ndaj atij shpirti.

Përkundrazi, ne e hasim atë duke u përpjekur të gjejë – ndonjëherë në rrafshet romantike-idealiste, ndonjëherë në rrafshet racionale-lëndore – ato shenja dhe figura të cilat individi luftëtar përpiket ti vendosë në flamujt e tij.

Por vlera që mbartin këto rrafshet i përket pjesërisht të shkuarës dhe pjesërisht një mjedisi të huaj për gjeninë Gjermane; nuk mjafton ti garantosh devotshmëri të plotë zhvillimit të njerëzve dhe makinerive – diçka që i nevojitet një beteje të frikshme kundër një bote.

Duke e marrë këtë gjë në konsideratë ne duhet të përpiqemi edhe më tepër të vërejmë sesi përbërja jonë thelbësore, fuqia e thellë parake e Kombit nuk gjendet nga një kërkim i tillë.

Me admirim ne shohim se si rinia Gjermane, në fillim të kësaj kryqëzate të arsyes për të cilën kombet e botës thirren nën magjinë/yshtjen e një dogme kaq të qartë e të tejdukshme, jep kushtrimin për luftë: duke shkëlqyer, me ngazëllim, të uritur për vdekje në një mënyrë pothuaj të paparë në historinë tonë.

Nëse do të ishte pyetur një nga këta të rinj për arsyen e shkuarjes në front, përgjigjia, sigurisht, do të ishte më pak e qartë. Ai zor se do të kishte folur për luftën kundër barbarizmit dhe reaksionit ose për qytetërimin, çlirimin e Belgjikës ose lirinë e deteve; por ndoshta do të kishte kthyer përgjigjen, “për Gjermaninë” - atë shprehje në gojë, me të cilën regjimentet vullnetare hidheshin në sulm.

E prapë, ky zjarr, që digjej për një Gjermani të padukshme dhe enigmatike, ishte i mjaftueshëm për një përpjekje që i bëri kombet të dridheshin në palce. Po sikur ky zjarr të kishte patur drejtim, vetëdije dhe *trajtë*?

6) Si një mënyrë e mendimit organizativ, Mobilizimi Total është thjesht një aludim për atë mobilizim edhe më të madh që epoka na sjell. Tipar veçues i llojit të *fundit* është një ligjshmëri/rregull e brendshme me të cilën lighet njerëzore duhet të përputhen në mënyrë që të sjellin dobi (të bëjnë efekt).

Asgjë nuk e vërteton këtë pretendim më mirë se fakti që gjatë luftës mund të shfaqen forca që kanë qëndrim kundër vetë luftës. Megjithatë, këto forca janë të lidhura më tepër se sa mund të duket në pamje të parë me fuqitë që janë pjesëmarrëse në luftë. Mobilizimi Total e ndryshon rrafshin e vet të veprimit, por jo kuptimin e tij, kur nis të vendosë në lëvizje masat në një luftë civile në vend të ushtrive të luftës.

Përleshja tani arrin rrafshje që nuk preken nga urdhrat e mobilizimit ushtarak. Njëjtë sikur forcat që nuk mund të rreshtoheshin për luftën të kërkonin një rol pjesëmarrës në përleshjen gjakatare. Rrjedhimisht sa më e bashkuar dhe e thellë orvatja e luftës për të thirrur në armë për çështjen e saj, që nga fillimi, të gjitha forcat e mundshme, aq më i sigurt dhe i palëkundshëm do të jetë zhvillimi i saj.

Kemi parë se në Gjermani shpirti i përparimtarizmit mund të vepronte vetëm pjesërisht. Të marrim vetëm një nga mijra shembuj, rasti i Barbusesë na tregon se në Francë, për shembull, rrethanat ishin shumë më tepër të volitshme.⁴

Në të vërtetë një kundërshtar i zëshëm i luftës, Barbuseja vetëm mund ti qëndronte besnik bindjeve të tij duke pohuar me dëshirë *këtë* ide: sipas mendjes së tij, ajo pasqyronte një përpjekje për përparim, *qytetërim*, njerëzim madje dhe paqe, kundër një parimi në kundërshtim me të gjithë këta faktorë (të gjitha këto ideale). “Lufta duhet të vritet në mitër të Gjermanisë.”

Pavarësisht sa e ngatërruar na duket kjo dialektikë, përfundimi i saj është i patundshëm. Një njeri që në pamje të parë ka prirjet më të pakta për luftë prapëseprapë e gjen veten të paaftë për ta kundërshtuar pushkën që i jep shteti pasi mundësia për të bërë një zgjedhje tjetër nuk i shkon në mendje.

Le ta shohim sesi shtrydh trutë e tij, duke qëndruar rojë në shkretëtirën e llogoreve të pafundme, sesi braktis llogoret si dhe këdo kur vjen dita, që të përparojë përmes perdes së tmerrshme të zjarrit të luftës së makinerive.

4 Shënim i përkthyesit: Henri Barbuse (1873-1935), shkrimtar francez përvoja e të cilit në Luftën e Parë Botërore e ktheu atë në një paqësorist. Në 1916-tën ai shkroi romanin me nam kundër luftës me titull *Le feu* (*Nën Zjarr*).

Po ku qëndron, në fakt, çudia këtu? Barbuseja është një luftëtar si kushdo tjetër: një luftëtar për njerëzimin, aq i aftë të heqë dorë nga zjarri i mitralozit dhe sulmit me gaz, madje edhe nga gijotina, sa ç'është e aftë kisha e Krishterë të heqë dorë nga shpata e saj e përbotshme. Të jemi të sigurt/qartë, në mënyrë që të arrihet kjo shkallë e tillë mobilizimi, një Barbuseje do i duhej të jetonte në Francë.

Barbusetë e Gjermanisë e gjetën veten në rrethana më të vështira. Vetëm mendje të veçuara u shpërngulën që herët drejt paanshmërisë duke vendosur të pengojnë haptazi përpjekjen luftarake. Masa e gjerë u përpoq të mbështesë vajtjen në front. Tashmë kemi folur mbi çështjen e demokracisë shoqërore Gjermane.

Le ta shpërfillim faktin që, pavarësisht dogmës së saj ndërkombëtariste, rradhët e lëvizjes ishin të mbushura me punëtorë Gjermanë e rrjedhimisht mund të nxiteshin drejt heroizmit. Jo – në vetë ideologjinë e saj, u zhvendos drejt një rishikimi që më vonë solli akuzën e “tradhtisë ndaj Marksizmit.” Ne mund të kuptojmë deri diku hollësitë e procesit me anë të fjalimeve të mbajtura gjatë periudhës vendimtare nga Ludvig Frank, drejtuesi Shoqëror-Demokratik dhe deputet i Rajhshtagut, i cili, si një vullnetar dyzetë vjeçar, u vra nga një plumb në kokë në Noisonkort në Shtator të vitit 1914.

“Ne shokët pa atdhe prapë e dimë që edhe si thjeshtër prapë ne jemi fëmijë të Gjermanisë dhe se ne duhet të luftojmë për atdheun tonë kundër reaksionit(reagimit, rikthimit). Nëse plas një luftë edhe ushtarët Shoqëror-Demokratikë me vetëdije do të përmbushin detyrën e tyre” (29 Gusht, 1914).

Ky paragraf tepër ndriçues/shpjegues përmban në pak fjalë trajtat e luftës dhe përmbysjes/revolucionit që fati mban në gatishmëri.

Për ata që dëshirojnë të studiojnë këtë dialektikë hollësishtëm, faqet e gazetave dhe fletoreve gjatë viteve të luftës mbartin shumë shembuj. Si rrjedhim Maksimilian Hardeni- redaktori i *Die Zukunft* dhe ndoshta gazetari më i njohur i kohëve Vilhelmiane- nisi të rregullonte veprimtarinë e tij publike në përputhje me qëllimet e shtabit qëndror.

Vërejmë, vetëm me aq sa shfaqet, se si ai dinte të shfrytëzonte me dinakëri skajshmërinë e luftës e po ashtu më vonë edhe atë të Revolucionit/Përmbysjes.

E kështu, dalim tek *Simplicissimus*,” një qenie që i kishte drejtuar armëet e veta të humorit nihilist kundër të gjitha lidhjeve shoqërore e për rrjedhojë edhe kundër ushtrisë, që befas merr një ton shovinist. është e qartë, për më tepër, që cilësia e fletores venitit me rritjen e tonit atdhetar të vet- më saktë, kur braktis rrafshin në të cilin ka epërsi.

Ndoshta përlëshja e brendshme që po shtjellohet këtu është më e dukshme në rastin e Rathenaut;⁵ i jep vesh figure për këdo që përpiqet të jetë i drejtë me të-tisin e tragjedisë.

Në një shkallë të dukshme, Rathenau ishte mobilizuar për luftën, duke luajtur një rol në organizimin e armatosjes vigane

⁵ Shënim i përkthyesit: Valter Rathenau (1867-1922), industrialist kryesor Gjerman që luajti një rol kyç në organizimin e furnizimit të industrisë së luftës të Gjermanisë me lëndë të parë gjatë Luftës së Parë Botërore. Shërbeu si ministër i rindërtimit dhe ministër i jashtëm gjatë Republikës së Vejmarit dhe negocioi Traktatin e Rapallos me Bashkimin Sovjetik. Rathenau, që ishte hebre, u vra nga ekstremistë të djathtë në 24 qershor të 1922-it.

dhe duke u përqëndruar – madje afër humbjes së Gjermanisë – tek mundësia e një “kryengritjeje masive.”

Si është e mundur që pak më vonë, ai të mund të thoshte vërejtjet e famshme se historia botërore do të kishte humbur kuptimin e saj nëse përfaqësuesit e Rajhut do të kishin hyrë në kryeqytet si triumfues përmes Portës Brandenburgiane? Këtu shfaqet qartë se si shpirti i mobilizimit mund të drejtojë aftësitë teknike të dikujt e prapë të dështojë së bëri për vete shpirtin e tij/ të mos arrijë të prekë thelbin e tij.

7) Me luftëtarët tanë të fundit që ende dergjeshin para armikut, ushtria e fshehtë dhe shtabi i përgjithshëm i fshehtë që drejtonin përparimtarizmin Gjerman e pritën rrënimin me ngazëllim.

Ngjante me ngazëllimin për fitoren e një beteje. Ishte aleati më i afërt i ushtrive Perëndimore që së shpejti do të kalonin Rinin, kali i tyre Trojan. Autoritetet sunduese e pranuan shpirtin e ri duke kundërshtuar pakëz kur braktisën me ngut përgjegjësitë e tyre. Midis mikut dhe armikut kishte pak ndryshim thelbësor.

Kjo është gjithashtu arsyeja pse në Gjermani, shndërrimi politik[që erdhi pas dështimit ushtarak] mori një trajtë krahasimisht të padëmshme.

Kështu, madje edhe gjatë ditëve kyçe të vendimmarrjes, ministri Shoqëror-Demokratik i Perandorisë mund të luante me idenë e ruajtjes së mbretërisë. E çfarë kuptimi do të kishte patur kjo gjë përveç se ruajtjen e kurorës sa për sy e faqe?

Për një kohë të gjatë, ndërtesa kishte qenë e rënduar aq shumë nga borxhet “përparimtariste”, sa nuk kishte më dyshime mbi natyrën e pronarit të vërtetë.

Por ka një tjetër arsye përse ndryshimi mund të ndodhte më paqësisht në Gjermani se për shembull në Rusi- përveç faktit që autoritetet vetë çelën udhën për ndryshimin. Kemi parë se një pjesë e madhe e “forcave përparimtariste” kishin qenë tashmë të zëna me drejtimin e luftës.

Energjia e harxhuar pa kufij gjatë luftës nuk ishte më aty për përlëshje të brendshme. Për ta thënë më troç: ka ndryshim kur frerët i marrin ish-ministra dhe kur frerët i marrin aristokratë revolucionarë të shkolluar gjatë dëbimit në Siberi.

Gjermania e humbi luftën duke fituar kështu një post më me rëndësi në botën Perëndimore, të qytetërimit, paqes dhe lirisë në kuptimin Barbusian. Por si mund të prisnim gjë tjetër kur ne vetë u betuam për besnikëri ndaj këtyre vlerave; për asnjë lloj çmimi ne nuk do të kishim guxuar ta përhapnim luftën përtej atij “muri të mbështjellë përreth Europës.”

Që të kryhej kjo gjë do të ishin nevojitur ide të ndryshme dhe aleatë të tjerë, një shpërfaqje më të gjerë të vlerave tona vetjake. Një nxitje e shpirtit mund të kishte ndodhur me anë të dhe përmes optimizmit përparimtarist, siç na tregon rasti i Ruisë.

8) çfarë ndikim i njëjtë, çfarë njëtrajtshëmri historike pabesueshmërisht e sertë kur përsiatemi mbi botën që doli në pah pas gjëmës! Vërtet, edhe nëse gjithë objektet shpirtërore dhe fizike të një lloji joqytetërimor që datojnë nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë e deri në kohën tonë do të ishin mbledhur në një vend të vogël dhe do të ishin shkrepur të gjitha armët e botës mbi ta, suksesi nuk mund të kishte qenë më kumbues.

Zilkat e vjetra të Kremlinit tani luajnë sipas tingujve të Ndërkombëtares. Në Konstandinopojë, nxënësit përdorin gërmat Latine në vend të gërmave të vjetra Arabike të Kuranit. Në Napoli dhe Palermo, policia Fashiste e organizon ritmin e jetës jugore sikur po organizon trafikun modern të automjeteve.

Në vendet më të humbura e madje në vende për të cilat lexojmë në përralla, ngrehina të kuvendit po bekohen me ceremoni. Patrajtësia e si rrjedhim tmerri i gjithë rrethanave njerëzore po rritet pashmangshëm. Atdhetaria po ndotet nga një nacionalizëm i ri, i shkrirë fuqishëm me tipare të dijes së vetëdijshme (arsyes?).

Në Fashizëm, Bolshevizëm, Amerikanizëm, Zionizëm, në lëvizjet e njerëzve me ngjyrë, përparimtarizmi ka marrë hove që deri vonë do ishin menduar të paimagjinueshëm. Ai shtjellohet, si të thuash, turavrap, duke ndjekur shtegun si qerthull të një debati të rremë që të mund të vazhdojë rendjen e vet mbi një rrafsh të thjeshtë.

Duke i shpërfillur mundësitë e zvogëluara për liri e shoqërueshmëri, po fillon ti sundojë kombet në mënyra të ngjashme me ato të regjimeve absolute.

Në shumë raste maska njerëzoriste pothuajse është hequr, duke i lënë vendin një fetishizmi gjysëm të shëmtuar e gjysëm barbar ndaj makinerisë, një kult fëmijënor ndaj teknikës.

Kjo gjë ndodh në veçanti në ato vende ku nuk ka marrëdhënie të drejtpërdrejtë e te frytshme me ato energji për të cilat shtegu shkatërrimtar e ngadhënjimtar i artillerisë me qitje të largët dhe grupet e fluturakëve të ngarkuar me bomba, përfaqësojnë vetëm fytyrën luftarake.

Në të njëjtën kohë, vlerësimi ndaj masës/masives/sasisë po rritet. Sasia e miratimit, masa e mendimit publik është kthyer në faktorin vendimtar në politikë. Shoqërorizmi dhe nacionalizmi në veçanti janë dy gurët e mëdhenj të mullirit midis të cilëve përparimi bluan atë që ka mbetur nga bota e vjetër dhe si përfundim edhe vetveten.

Për një periudhë mbi një shekullore, turmat, të verbuara nga vegimi pamor i ekzistencës apo jo të privilegjizimit, u hodhën lart e poshtë si top nga e “djathta” dhe e “majta”. Ngjante gjithmonë se njëra palë i premtonte mbrojtje njerëzve nga pretendimet e palës tjetër dhe e anasjellta.

Sot kudo fytyra e vërtetë e secilës palë po bëhet gjithmonë e më e dukshme. Madje edhe ëndrra e lirisë po zhduket sikur të ishte nën mbërthimin e hekurt të pincave. Lëvizjet e turmave të njëtrajtshme, të futura në kurth nga shpirti i botës janë një shfaqje e madhe dhe frikshme.

Secila nga këto lëvizje çon në një shtrëngim edhe më të fortë e të pamëshirshëm. Kemi të bëjmë me lloje të detyrimit më efektive se tortura, aq efektive sa qenia njerëzore i pret ato me hare. Mbrapa çdo rrugëdaljeje, të shenjuar me shenjën e lumturisë, fshihet dhimbja dhe vdekja. I lumtur është vetëm ai që futet i armatosur në këto shtigje.

9) Sot, përmes të çarave dhe plasaritjeve të kullës së Babelit, tashmë mund të shohim një botë-akullnajë. Kjo pamje i bën edhe shpirtrat më të guximshëm të dridhen. Nuk është e largët dita kur periudha e përparimtarizmit do të na ngjajë po aq e çuditshme sa misteret e një dinastie Egjiptiane.

Në atë periudhë, sidoqoftë, bota lavdëronte një nga atyre ngadhënjimeve që i vesh fitores, për një çast, me aureolën e

përjetësisë. Më të rrezikshëm se Hanibali, me grushta të gjithëfuqishëm, ushtri të sërta kishin trokitur mbi portat e qyteteve të tij madhështore dhe hendeqeve të fortifikuara.

Në thellësitë e kraterit, lufta e fundit mbarte një kuptim që asnjë aritmetikë nuk mund të ketë. Vullnetari e ndjeu këtë gjë në ngazëllimin e tij, zëri që buçiti fuqishëm i demonit Gjerman, shterja e vlerave të vjetra që u bashkuan me një etje të pavetëdijshme për një jetë të re.

Kujt do t'ia kishte marrë mendja se këta bij të një brezi materialist/lëndorist mund ta përshëndesnin vdekjen me kaq zjarr? Kështu e shpall veten një jetë e mbushur me teprime dhe që nuk e njeh kursimin e lypësit.

E ashtu siç frytet e vërteta të një jete të denjë nuk janë gjë tjetër veçse arritja e unit më të thellë të njeriut, për ne frytet e kësaj lufte nuk mund të jenë gjë tjetër veçse arritja e një Gjermanie më të thellë. Kjo vërtetohet nga gjallëria përreth nesh që është shenja e një race të re.

Një race të re që nuk mund të mjaftohet/kënaqet me asnjë nga idetë e botës apo nga ndonjë ide e së shkuarës. Një rrëmujë e frytshme sundon/mbretëron këtu, e cila lind nga përbërësit e dheut dhe zjarrit dhe që fsheh brenda vetes farat e një trajte të re të mbizotërimit.

Këtu del lakuriq një mënyrë e re e armatosjes, një që përpiqet ti farkëtojë armët e veta nga xehe më të pastra e të forta që qëndrojnë të papërshkueshme nga çdo qëndresë.

Gjermani e zhvilloi luftën me synim, që për Gjermanin ishte tepër i arsyeshëm, të qenurit një European i mirë. Duke qenë se Europa si rrjedhim luftoi me Europën-kush tjetër veç Europës mund të ishte fitues?

Prapëseprapë, kjo Europë, shtrirja e së cilës ka madhësi të shkallës së një rruzulli, është holluar pamasë, është mbillustruar. Zgjerimet në hapësirë kanë shkuar dorë më dorë me një humbje të fuqisë së bindjeve. Fuqi të reja do të dalin në pah nga ajo.

Thellë brenda hapësirave në të cilat ka kuptim dialektika e synimeve të luftës, Gjermani ndesh një forcë më të madhe. Ai ndesh vetveten.

Kështu, lufta në të njëjtën kohë ishte për atë. Mbi të gjitha, ishte rruga me anë të së cilës Gjermani u vetë-ndërgjegjësua. Prandaj, mënyra e re e armatosjes, të cilën tashmë ne kemi ca kohë që kemi nisur ta kryejmë, duhet të jetë një mobilizim i Gjermanit e asgjë tjetër.